



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
DHE TURIZMIT
BASHKIA MAT
KRYETARI

Nr. _____ Prot.
_____._____.2020

Burrel, më

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin Ekonomik: “**HOREAL Expo Group**” Sh.p.k, me numër Nipt-i: **L52313007M**

Adresa: *Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani " Torre Drin, Nr. 35/1, Tiranë.*

Procedura e prokurimit: “**Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit - Shërbime**”.

Numri i referencës së procedurës: **REF-54910-03-25-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Blerje materiale mbrojtëse (mjekësore) dhe dezinfektim të ambjenteve publike të Bashkisë Mat**”, me fond limit: **2 083 333** (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH** vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit (grandi), me afat realizimi të kontratës **2 (dy) muaj** nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikime të mëparshme: *nuk ka patur*

Buletini i Njoftimeve Publike:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatorin Ekonomik: “**HOREAL Expo Group**” Sh.p.k, me numër Nipt-i:
L52313007M

Vlera: **2 056 924** (dy milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e katër) **lekë pa TVSH**

2. Operatorin Ekonomik: “**Viola Green**” Sh.p.k, me numër Nipt-i:
L51928004K

Vlera: **Nuk ka paraqitur ofertë** (oferta e pafirmosur)

Janë s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- ❖ **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik, shoqëria “Viola Green” Sh.p.k për pjesëmarrje në tender, rezulton se nuk përmbush të gjithë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me Kriteret e Veçanta të Pranimit/ Kualifikimit, si më poshtë:**

I. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 1/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 2.

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi Oferta e paraqitur nuk është e firmosur, si dhe nuk është plotësuar sipas Shtojcës 2 të DST-së**

II. Nuk është përmbushur përcaktimi i pikës 2.1.1/ 2.1 Për kapacitetin ligjor-profesional/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk është paraqitur Liçencë, Kodi II.8.B - për kryerjen e shërbimeve ndërhyrëse higjieno – shëndetësore (dezinfektim, deratizim, dezinfektim)**

III. Nuk janë përmbushur përcaktimet e pikave: 2.2.1 dhe 2.2.3/ 2.1 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar / 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk janë paraqitur**
 - Kopje të vërtetuar të bilanceve, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme
 - Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, **nuk konfirmon shlyerjen e detyrimeve për muajin Janar 2020.**

IV. Nuk janë përmbushur përcaktimet e pikave: 2.3.1 - 2.3.6/ 2.3 Kapacitetin teknik/ 2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit:

- **Ky kusht nuk përmbushet nga ana e Operatorit Ekonomik, pasi nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nga ana Juaj për përmbushjen e kushteve të kërkuara për kapacitetin teknik në pikat nga 2.31 deri në pikën 2.3.6 në DST.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik: **“HOREAL Expo Group”** Sh.p.k, me seli: *Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga "Abdi Toptani " Torre Drin, Nr. 35/1, Tiranë*, me numër Nipt-i: **L52313007M**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **2 056 924** (*dy milion e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet e katër*) **lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkisë Mat** me adresë: *Sheshi “Ahmet Zogu”, Nr.1, KP 8001, Burrel*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **1 (një) dite** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe do të procedohet konform dispozitave ligjore në fuqi të parashikuara nga Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: **27.03.2020**

Titullari i Autoritetit Kontraktor